



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

Nr. 1211/6 Prot.

Tiranë, më 14.15.2016

V E N D I M

Nr. 53, Datë 14.05.2016

**PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË
“SPITALIN UNIVERSITAR “SHEFQET NDROQI” TIRANË”, MBI
ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË
AKTIVITETIT EKONOMIK DHE FINANCIAR PËR PERIUDHËN
01.01.2014 DERI MË 31.12.2015**

Pasi u njoha, me Raportin Përfundimtar të Auditimit, me Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike, me shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, me mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikes, me vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit ekonomik dhe financiar*” të ushtruar në Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, për periudhën 01.01.2014 deri më 01.09.2015.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje. Nuk janë zbatuar plotësisht të gjitha rekomandimet e lëna nga auditimi i mëparshëm me shkresën nr. 1067/4 datë 10.11.2013, konkretisht:

Në auditimin e mëparshëm të KLSH-së, janë lënë për zbatim 13 masa organizative dhe 5 masa për shpërblim dëmi. Nga 13 masa organizative: 10 masa janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 2 masa nuk janë zbatuar; ndërsa nga 5 masa për shpërblim dëmi,

2 masa janë zbatuar plotësisht, 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 2 masa nuk janë zbatuar, trajtuar (*Trajtuar më hollësisht në faqen 15-17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: Të merren masat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 1067/4 datë 10.11.2013.

Menjëherë

2. Gjetje: Nuk është marrë asnjë masë dhe nuk është bërë asnjë ndryshim për të përshtatur statutin e SUSHNT me VKM nr. 823 datë. 11.06.2008, me anën e të cilit ku spital është kthyer, nga Spital Universitar i Sëmundjeve të Mushkërive “Shefqet Ndroqi” në Spital Universitar të Nivelit Tercial (*Trajtuar më hollësisht në faqen 17-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Të reflektohen të gjitha ndryshimet në Statutin e SUSHNT, për ta përshtatur atë me kërkesat e VKM nr. 823 datë 11.06.2008.

Menjëherë

3. Gjetje: Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të Spitalit është hartuar dhe miratuar nga Drejtori i SUSHNT në dhjetor të vitit 2014, në të cilën përfshihen edhe ndryshimet sipas VKM-së së sipërcituar. Po kështu edhe plani Strategjik për vitin 2015-2017 është hartuar dhe miratuar nga Drejtori i SUSHNT në mars të vitit 2014. Por këto dokumente nuk janë miratuar nga Këshilli Administrativ në kundërshtim me Statutin e SUSHNT dhe me ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 17-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Rregullorja e Brendshme dhe plani Strategjik për vitin 2015-2017 të dërgohen për miratim në Këshillin Administrativ në mbledhjen më të afërt të tij.

Menjëherë

4. Gjetje: Në kundërshtim me, Statutin e SUSHNT, me Rregulloren e Brendshme dhe me ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” nuk është marrë asnjë masë dhe nuk është kërkuar ngritja dhe nuk funksionon Këshilli Administrativ i Spitalit (*Trajtuar më hollësisht në faqen 17-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Të ngrihet dhe të funksionoi Këshilli Administrativ i Spitalit, në përputhje me Statutin, me Rregulloren e Brendshme dhe me ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”.

Menjëherë

5. Gjetje: Në kundërshtim me, Statutin e SUSHNT dhe me ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” nuk është ngritur “Komisioni Mjekësor” i cili funksionon si, organ konsultativ pranë Drejtorit të SUSHNT.

Rekomandim: Të ngrihet “Komisioni Mjekësor” pranë Drejtorit SUSHNT sipas kërkesave të Statutit dhe ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për Shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 17-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

6. Gjetje: Në kundërshtim me ligjin nr. 9154 datë. 06.11.2003 “Për Arkivat në Republikën e Shqipërisë”, nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar Protokoll-Arkiva e spitali. Shërbimet e

protokoll-arkivës janë kryer dhe kanë funksionuar si mini-arkiva në zyra të veçanta të administratës së SUSHNT (*Trajtuar më hollësisht në faqen 17-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Të ngrihet dhe të funksionoi Protokoll-Arkiva në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9154 datë. 06.11.2003 “Për Arkivat në Republikën e Shqipërisë”

Menjëherë

7. Gjetje: Janë përgatitur dhe hartuar regjistrat e parashikimit dhe realizimit të prokurimeve për blerjet me vlera të vogla për të dy vitet. Por regjistrat e parashikimit nuk janë detajuar sipas llojit të mallrave, shërbimeve dhe punimeve që do të prokurohen, në kundërshtim me Udhëzimit nr. 1 datë 01.02.2013 “Për blerjet e vogla” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Për çdo vit regjistrat e parashikimit të prokurimeve të detajohen për kontratat e mallrave, shërbimeve dhe punimeve që kërkohen të prokurohen.

Vazhdimisht

8. Gjetje: Gjatë vitit 2014 janë realizuar blerjet me vlera të vogla në vlerë të përgjithshme 12,385,417 lekë. U konstatua se, 17 praktika të blerjeve me vlera të vogla në vlerën totale **7,740,585 lekë**, janë realizuar për raste emergjence, nëpërmjet procedurave prokurimi manuale (me dokumente) duke eliminuar procedurat nëpërmjet sistemit elektronik të APP, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1 datë 01.02.2013 “Për blerjet e vogla”. Kërkesat bashkëlidhur këtyre praktikave nuk argumentojnë dhe justifikojnë kryerjen e këtyre blerjeve si raste emergjent, sepse nevojat emergjente për realizimin e kësaj procedure ka ardhur si pasojë e mos planifikimit që në fillim të vitit për blerjen e barnave, materialeve mjekësore, shërbimeve apo punëve të ndryshme. Justifikimi i blerjeve me vlera të vogla për raste emergjence, duke eliminuar realizimin e procedurave nëpërmjet sistemit elektronik, shmang konkurrencën, kufizon tregun dhe njëkohësisht lejon hapësira për favorizime të njëanshme në përzgjedhjen e operatorëve ekonomik” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 28-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Për çdo rast procedurat me vlera të vogla për raste emergjence, të argumentohen dhe justifikohen me dokumente sipas kërkesave të udhëzimeve për blerjet e vogla.

Vazhdimisht

9. Gjetje: Në disa procedura me vlera të vogla të realizuara nëpërmjet sistemit elektronik është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin i sipërcituar sepse, nuk është bërë arkivimi i procedurës së prokurimit brenda 1 ditë punë nga mbyllja e fazës së njoftimit të fituesit.

Rekomandim: Në çdo rast procedurat me vlera të vogla të arkivohen brenda 1 ditë punë nga mbyllja e fazës së njoftimit të fituesit (*Trajtuar më hollësisht në faqen 28-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Vazhdimisht

10. Gjetje: Gjatë vitit 2015, janë realizuar rreth 150 procedura me blerje të vogla me vlerën të përgjithshme **30,217,416 lekë**. Pothuajse në gjitha rastet e blerjeve me vlera të vogla nuk është bërë argumentimi i përllogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me VKM nr. 914 “Për Miratimin e Rregullave të prokurimit Publik” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 31-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Në çdo procedurë prokurimi me vlera të vogla, fondi limit të llogaritet dhe të dokumentohet me procesverbal përkatës.

Vazhdimisht

11. Gjetje: Në shumë raste procedurat me blerjeje me vlera të vogla të realizuara në vitin 2015, nuk kanë filluar me kërkesë të sektorëve përkatës të cilat kanë nevojë për mallra, shërbime dhe punë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3 date 27.01.2015, “Për prokurimet me vlera të vogël” (*Trajtuar më hollësisht në faqen 32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Në çdo rast procedurat me vlera të vogla, të fillojnë në bazë të kërkesave të sektorëve përkatës të cilat kanë nevojë për mallra, shërbime dhe punë.

Vazhdimisht

12. Gjetje: Gjatë vitit 2015, fondi limit në vlerën totale prej 3,740,000 lekë është prokuruar në kundërshtim me UKM nr. 3 datë 27.01.2015 “Për blerjet e vogla” sepse, për të njëjtën grup artikujsh apo natyrë, malli, shërbim dhe pune, janë realizuar 2 dhe më shumë procedura, të ndara secila veçmas nën vlerën 120 mijë lekë, me TVSH. Kjo vlerë prej 3,740,000 lekë është copëtuar në shumë pjesë, me qëllim shmangien e procedurave elektronike dhe përdorimin e procedurës së prokurimit nën vlerën 20 mijë lekë, procedurë e cila realizohet me dokumentacion dhe jo me sistemin elektronik. Konkretisht:

-Në 7 raste janë kryer procedura blerje për: lule, vazo lulesh, humus, ushqyes lulesh, mbajtëse vazosh dhe lule natyrale. Të 7 këto procedura janë realizuar në rrugë shkresore dhe vlera e fondit limit të secilës procedurë nuk kalon 120 mijë lekë, dhe në total së bashku për të 7 procedurat fond limit shkon në vlerën 828,720 lekë. Pra këto blerje në zbatim të udhëzimit të mësipërm duheshin grupuar dhe duhej bere një procedurë e vetme nëpërmjet sistemit elektronik. Kështu me radhë po perëndim edhe rastet e tjera:

-Në 6 raste janë kryer procedura blerje për, aksesori, profile xhami, xham i përpunuar, profile dhe në total së bashku fond limit shkon në vlerën 544,280 lekë.

-Në 3 raste janë blerë, karrige, tavolina dhe banak, në total fond limit shkon në vlerën 291,000 lekë.

-Në 4 raste janë blerë bateri, goma, si dhe është kryer servis makinash, në total fond limit shkon në vlerën 308,800 lekë.

-Në 8 raste janë blerë: letër, bojëra printer, bojë kompjuteri, letër ekg, CD, kancelari etj, dhe në total fondi limit shkon në vlerën 624,120 lekë.

-Në 2 raste janë blerë: bateri UPS dhe së bashku fondi limit shkon në vlerën 237,360 lekë.

-Në 7 raste janë blerë, llapma, prozhektor, ndriçues, sinjale, kabull etj, dhe në total fondi limit shkon në vlerën 555,000 lekë.

-Në 5 raste janë blerë: bojëra plastike bojë hidromat, pigmente, brava etj, dhe në total fondi limit shkon në vlerën 593,080 lekë.

(*Trajtuar më hollësisht në faqen 32-35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Për të njëjtën grup artikujsh apo natyrë, malli, shërbim dhe pune, kur vlera e të cilave është mbi 120 mijë lekë të realizohet një procedurë e vetme nëpërmjet sistemit elektronik.

Vazhdimisht

13. Gjetje: Në kundërshtim me, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, komisionet apo punonjës të veçantë të ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave në tërësi, nuk kanë përgatitur raport që të pasqyrohet nëse cilësia e punëve, shërbimeve ose e mallrave është e njëjtë me

cilësinë e premtuar në ofertë (*Trajtuar më hollësisht në faqen 35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Në çdo rast komisionet apo punonjësit e ngarkuar për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave, në përfundim të kontratave të përgatisin raportin për pasqyrimin e cilësisë së punëve, shërbimeve dhe mallrave.

Vazhdimisht

14. Gjetje: Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, TAK për vitin 2015, nuk ka ngritur komisione të pritjes së mallit ose marrjes në dorëzim që në fillim të vitit, për pasojë disa pagesa janë kryer në kundërshtim me kushtet e kontratave, pasi dhe nuk është bërë kontrolli dhe kolaudimin e mallit nuk janë mbajtur procesverbalet e pritjes së mallit sipas specifikimeve teknike. Po kështu disa urdhër-shpenzimeve u mungon dokumentacioni justifikues si, kontratat, procesverbalet e marrjes në dorëzim të mallit, situacionet e punimeve, preventivat, etj, (*Trajtuar më hollësisht në faqen 35, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Në çdo fillim viti të ngrihen komisionet e marrjes në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe punëve. Në çdo urdhër-shpenzimi (pagesë) të lidhet dokumentacioni justifikues dhe plotësues që vërteton kryerjen e pagesës.

Vazhdimisht

15. Gjetje: SUSHNT në fund të vitit 2014 është gjobitur nga Instituti i Shëndetit Publik me gjobë 300,000 lekë sepse në ambientet e spitalit ka konstatuar shkelje të ligjit nr. 9636 datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit”. Më pas gjykata administrative ka nxjerr urdhër ekzekutimi vendimi për tu paguar nga spitali gjoba së bashku me shpenzimet gjyqësore në vlerën 326,400 lekë. Me urdhrin nr. 627 datë 07.12.2015, Drejtori i SUSHNT ka urdhëruar kryerjen e kësaj pagese dhe me urdhër-shpenzimi nr. 687 datë 09.12.2015 është kryer pagesa në favor të [REDAKTUAR], në vlerë 326,400 lekë. Pra nga veprimet apo mosveprimet e kryera nga drejtori i Spitalit në shkelje të këtij ligji, përveç sa i është i është shkaktuar buxhetit SUSHNT dem ekonomik në vlerën 326,400 lekë, tregon edhe për papërgjegjshmëri në kryerjen e detyrës, pasi ky institucion ka për objekt të punës parandalimin dhe kurimin e sëmundjeve të mushkërive, për të cilin duhet të ishte në pararojë dhe në shembull të respektimit të këtij ligji (*Trajtuar më hollësisht në faqen 36, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Në ambientet e SUSHN të vendosen shenja të dukshme, që tregojnë se, pirja e duhanit në këto mjedise është rreptësisht e ndaluar, sipas kërkesave të ligjit nr. 9636 datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit”.

Menjëherë

16. Gjetje: Në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, nuk është kryer regjistrimi, në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë për ndërtesat në pronësi të SUSHNT.

Rekomandim: Të fillojë procedura e aplikimit për të regjistruar pasuritë e SUSHNT në ZVRPPT duke bërë menjëherë pagesat e tarifës së regjistrimit (*Trajtuar më hollësisht në faqen 38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë

17. Gjetje: Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 date 27.12.2011, “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” nuk janë hartuar, mbajtur dhe përditësuar regjistrat

kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron, SUSHNT si dhe nuk është caktuar nëpunësi zbatues për mbajtjen dhe krijimin e këtij regjistri (*Trajtuar më hollësisht në faqen 111, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Të caktohet nëpunësi zbatues për krijimin, mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit kontabël të aktiveve që ka në pronësi dhe zotëron SUSHNT.

Menjëherë

18. Gjetje: Në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 506, datë 18.09.2013 “Për ndalimin e procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve”, në 11 raste, janë kryer punësime të reja për pozicione të ndryshme (jo-mjekë). Me anë të këtij urdhri të Ministrit, është urdhëruar pezullimi deri në një urdhër të dytë, i procedurave të marrjes dhe largimit nga puna të punonjësve në institucionet shëndetësore. Po kështu, në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 247, datë 11.05.2004 “Për punësimin e stafit infermier” në 30 raste, janë punësuar infermierë pa kryer procedura konkurrimi (*Trajtuar më hollësisht në faqen 40, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Në çdo rast, marrja në punë e punonjësve të bëhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Vazhdimisht

19. Gjetje: Në kundërshtim me pikën 5 të Kreu III “Konflikti i interesave” të Statusit të SUSHN nr. 5637, datë 28.08.2006, nuk janë në dosjet e personelit të 11 shefave të shërbimeve dhe Drejtorit të SUSHNT deklaratat e konfliktit të interesit të shoqëruar me vërtetimin nga Ministria e Shëndetësisë. Në zbatim të kësaj pike të statusit, mjekët që punojnë në pozicionin e shefit të shërbimit dhe të Drejtorit të Spitalit, nuk u lejohej të drejtojnë apo punojnë në institucione të tjera shëndetësore (spitale) private (*Trajtuar më hollësisht në faqen 40-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Dosjet e personelit të 11 shefave të shërbimeve dhe e Drejtorit të Spitalit, të plotësohen me deklaratat e konfliktit të interesit të konfirmuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Menjëherë

20. Gjetje: Në tenderin “Blerje medikamente” me fondit limit në vlerë 4,073,537 lekë, me fitues operatorin “[REDAKTUAR]”, është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, sepse: një anëtar i KVO ka qenë njëherazi edhe anëtar i komisionit të llogaritjes së fondit limit. Në procesverbalin e negocimit nuk ka gjurmë mbi negocimin e ofertës së paraqitur nga operatori. Nuk është argumentuar vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim.

21. Gjetje: Në tenderin “Blerje medikamente”, me fondit limit në vlerën 2,381,732 lekë, me fitues operatorin “[REDAKTUAR]” është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse, një anëtar i KVO ka qenë njëherazi edhe anëtar i komisionit të llogaritjes së fondit limit si dhe nuk është argumentuar vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim.

22. Gjetje: Në tenderin “Blerje materiale mjekimi”, me fond limit në vlerën 6,416,095 lekë, me fitues “[REDAKTUAR]” është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, sepse: një anëtar i KVO ka qenë njëherazi edhe anëtar i komisionit të llogaritjes së fondit limit. Nuk është argumentuar vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim. Për përmbushjen e “kapaciteti ekonomik dhe financiar” dokumenti i bankës më shumë 10% të fondit limit është marrë rreth 7 muaj para hapjes së tenderit. Në procesverbalin e negocimit, nuk ka gjurmë mbi negocimin e çmimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik.

23. Gjetje: Në tenderin “Blerje oksigjen i lëngët”, me fond limit në vlerën 5,077,260 lekë me fitues operatorin ekonomik “██████” dhe në tenderin “Blerje kite reagente”, me fond limit në vlerën 438,400 lekë me fitues operatorin ekonomik “██████”, është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, sepse: nuk është argumentuar vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe në procesverbalin e negocimit, nuk ka gjurmë mbi negocimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomik.

24. Gjetje: Në tenderin “Blerje kite reagente”, me fond limit në vlerë 556,000 lekë me fitues operatorin ekonomik “██████” dhe në tenderin “Shërbimi për mirëmbajtjen e sistemit SIIS”, me fond limit në vlerën 1,083,333 lekë, me fitues operatorin ekonomik “██████” është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, sepse, nuk është argumentuar vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim.

25. Gjetje: Në tenderin “Shërbimi dhe mirëmbajtja e aparaturave mjekësore”, me fondit limit në vlerën 12,083,331 lekë me fitues operatorin ekonomik “██████” është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, sepse, një anëtar i KVO ka qenë njëherazi edhe anëtar i komisionit të llogaritjes së fondit limit si dhe nuk është argumentuar vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim.

26. Gjetje: Gjatë këtij viti janë realizuar dy tenderë me negociim për “Shërbimi i trajtimit me ushqim i pacientëve dhe mjekëve të spitalit”, njëra me fond limit në vlerën 7,048,554 lekë dhe tjetra me fond limit në vlerën 8,056,784 lekë, të dy i ka fituar operatori ekonomik “██████”. Në të 2 tenderët, është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, sepse:

Nuk është argumentuar vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, në procesverbalin e mbajtur për negocimin nuk është shprehur dhe nuk ka gjurmë për negocimin e vlerës së ofertës me subjektin “██████” për më tepër që, ky subjekt ka mbi 3 vjet që shpallet fitues i tenderit me këtë. Në specifikime teknike janë kërkuar specifika dhe parametra fiktiv që nuk bëjnë të mundur as kontrollin e tyre në momentin e kryerjes së shërbimit.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 41-58, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

27. Gjetje: Gjatë vitit 2015, SUSHNT, ka realizuar 10 procedura prokurimi me “Negocim pa shpallje paraprake të kontratës” me vlerë të përgjithshme rreth **47,154,602 lekë**. Këto procedura janë realizuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Sepse përzgjedhja e kësaj forme prokurimi, është justifikuar me nevojat emergjente për shkak të mungesës së medikamenteve, mallrave apo shërbimeve të ndryshme. Mirëpo, nevojat emergjente të këtyre mallrave dhe shërbimeve nuk janë shkaktuar për rastet e parashikuara në rregullat e prokurimit publik, por janë shkaktuar nga mos kryerja në kohë të procedurave të prokurimeve nga Autoritetit Kontraktor (AK). Drejtori i SUSHNT, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor (TAK), i ka pasur të gjitha mundësitë financiare, kohore e ligjore, për të përdorur procedura prokurimi standarde në përputhje me rregullat e prokurimit publik. Emergjencat për nevoja me medikamente, materiale mjekimi dhe shërbime apo blerje të ndryshme, nuk janë shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, por nga vetë autoriteti kontraktor, i cili nuk ka marrë masat e duhura për të filluar në kohë procedurat e prokurimit në zbatim të VKM-së nr. 32, date 23.01.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.1, date 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i cili e lejon TAK që, *pa pasur fonde në dispozicion, me miratimin e ligjit vjetor të buxhetit të vitit 2014, të fillojë menjëherë procedurat normale të prokurimit deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet vetëm pasi fondet do të jenë në dispozicion.* Po kështu edhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” që ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2015 dhe ka shfuqizuar VKM nr. 1, datë 10.01.2007, lejon që: *“me miratimin e ligjit për*

buxhetin, kur ka nevojë për punë, mallra dhe shërbime, TAK nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit. Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit. AK do të ftojë operatorin ekonomik të shpallur fitues që të lidhë kontratën menjëherë pas publikimit të njoftimit të fituesit, por në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e këtij publikimi”. Tregohet qartë se, me miratimin e ligjit për buxhetin në muajin dhjetor 2014, TAK duhej të fillonte procedurat e hapura ose kërkesë me propozim, kontratat e të cilave do të konkretizoheshin në fund të muajit janar ose shkurt; ndërsa nevojat gjatë muajve janar ose shkurt, për mallra, punë dhe shërbime do të mbulohen nga shtesat e kontratave të vitit të mëparshëm të cilat AK në muajin janar 2015 ka lidhur 45 shtesa kontrate me vlerë të përgjithshme 14,874,195 lekë. Pra, kjo procedurë në zbatim të nenit 33 të Ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, përdoret vetëm në raste tepër emergjente të mirë-argumentuar dhe jo kur emergjencat janë krijuar për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të vetë autoritetit kontraktor. TAK, përveç se, nuk ka filluar në kohë procedurat normale të prokurimit, nuk ka marrë edhe masat e duhura që të planifikonte në çdo vit buxhetor rezerva të medikamenteve dhe materialeve të mjekimit, shërbime apo blerje të ndryshme të domosdoshme këto për ushtrimin e aktivitetit normal të spitalit në shërbim të shëndetit publik. Nga mungesa e planifikimit apo e furnizimeve spontane vetëm për nevojat e rastit, janë krijuar emergjenca të mbartura nga viti në vit, duke e çuar nevojën për medikamente dhe materiale mjekimi apo shërbime dhe blerje të ndryshme në emergjenca të përhershme të cilat, siç u trajtua më sipër në kundërshtim me rregullat e prokurimit kanë diktuar përdorimin e procedurave me negociim pa shpallje paraprake të kontratës. Shmangja e procedurave standarde të prokurimit, me pretekstin e nevojave emergjente, krijon premisa për shmangien e konkurrencës dhe pengimin e hyrjes në tregun e barnave, medikamenteve, materialeve dhe shërbimeve të ndryshme mjekësorë të operatorëve ekonomikë që operojnë në këto tregje (*Trajtuar më hollësisht në faqen 59-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

28. Gjetje. Autoriteti kontraktor, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, për prokurimin e shërbimit me roje private për sigurinë fizike të ambienteve të SUSHNT, sepse përgjatë vitit 2015 ka realizuar 6 procedura prokurimi me vlerë të përgjithshme 10,895,083 lekë, të ndara veçmas me synim e vetëm për të favorizuar dhe dhënë kantatën e këtij shërbimi operatorit “██████████”. Respektivisht, ka zhvilluar 4 procedura me negociim dhe 2 procedura kërkesë për propozim nga e cila një është anuluar. Me konkretisht:

28.1. Për mbulimin me shërbimin e rojeve private të periudhën 06.01.2015-15.04.2015 është realizuar tenderi me “Negocim pa botim paraprak” me vlerë të përlllogaritur 3,789,826 lekë. Në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, nuk është argumentuar dhe dokumentuar arsyeja e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për negociim. Tenderi është zhvilluar në datën 31.12.2014 dhe kanë marrë pjesë 2 operatorë, janë kualifikuar të dy operatorët pjesëmarrës në këtë procedurë. Është shpallur fitues operatori “██████████” me ofertën ekonomike në vlerën 4,545,816 lekë.

28.2. Për mbulimin me shërbimin e rojeve private të periudhën 15.04.2015-15.06.2015 është realizuar tenderi me “Negocim pa botim paraprak” me vlerë të përlllogaritur 1,632,834 lekë. TAK, i ka dërguar ftesën për negociim operatorëve ekonomikë “██████████”, “██████████” dhe “██████████” dhe nuk i ka dërguar ftesën operatorit ekonomikë “██████████” i cili ka kryer këtë shërbim për periudhën e mëparshme të sipërcituar. Në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, nuk është argumentuar dhe dokumentuar arsyeja e përzgjedhjes së 3 operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për negociim si dhe arsye e mos përzgjedhjes së operatorit “██████████”. Tenderi është zhvilluar në datën 15.04.2015 dhe kanë marrë pjesë 3 operatorë, janë s`kualifikuar dy operatore dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues me ofertën ekonomike më të ulët operatori “██████████” në vlerën 1,919,520 lekë.

28.3. Për mbulimin e periudhës 15.06.2015-31.12.2015 është realizuar tenderi me “Kërkesë për propozim” me vlerë të kontratë 5,306,709 lekë. Tenderi do të hapej në datën 30.04.2015. Para hapjes së ofertave 5 operatore të interesuar për të marrë pjesë kanë bërë ankesë në AK për llogaritje gabim të fondit limit dhe gabime në DT. TAK pas shqyrtimit të këtyre ankesave ka anuluar tenderin. Tenderi është rishpallur përsëri dhe u zhvillua në datën 11.05.2015 dhe kanë marrë pjesë 18 operatorët, nga të cilat ofertën me te ulët e kishte paraqitur operatori “██████” në vlerën 5,094,650 lekë, ndërsa ofertën më të lartë e kishte paraqitur operatori “██████” në vlerën 5,272,889 lekë. KVO, me arsyen se, *nuk kishin llogaritur në analizën e tyre të kostos, ditët e diela dhe ditët e festave zyrtare, i ka s`kualifikuar të 18 operatorët pjesëmarrës dhe më pas TAK ka anuluar përsëri procedurën.* Mirëpo, këto s`kualifikime janë bërë në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse, në përlllogaritjen e fondit limit të bërë nga vetë AK janë përlllogaritur edhe ditët e diela dhe pushimet zyrtare. Ndodhur para këtij fakti, disa nga këta operatorë për këtë shkelje kanë bërë ankesë, por këto ankesa nuk janë marrë parasysh nga AK. Dhe më pas 2 nga këta operatorë dhe në veçanti operatori “██████” janë ankuar në Komisionin e Prokurimit Publik(KPP). Në përfundim KPP me vendimin nr. 421/1, datë 25.06.2015, vendosi që: *“të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “██████”. AK, mbështetur në konstatimet e KPP, të korrigjojë shkeljet, duke anuluar vendimin e KVO-së mbi anulimin e procedurës së prokurimit”*. Pas kësaj vijohet me vlerësimin e ofertave dhe përsëri në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, KVO i s`kualifikon 18 operatorët pjesëmarrës dhe TAK anulon përsëri këtë procedurë. S`kualifikimet janë bërë, me arsyetimin e përgjithshëm se, asnjë nga operatorët ekonomikë nuk kanë përlllogaritur ditët e festave dhe tek listë-pagesat nuk është zbatuar ligji për pagën minimale, dhe për disa operatorë të veçantë për mosplotësim të disa kriterëve e përcaktuara në DT. Edhe për këto s`kualifikime disa operatorë janë ankuar, por përsëri AK nuk i ka marrë në konsideratë. Më pas këta operatorë janë ankuar përsëri në KPP dhe me vendimin nr. 580/1, datë 31.08.2015, KPP vendos që, *të pranojë ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë dhe AK të anulojë vendimin e KVO-së mbi s`kualifikimin e operatorëve ekonomikë dhe mbështetur në konstatimet e KPP, të korrigjojë shkeljet, duke i kualifikuar këta operatorë ekonomikë.* Në zbatim të Vendimit të KPP, KVO vazhdon punën me vlerësimin e ofertave dhe në përfundim të këtij vlerësimi, 2 operatorë ankohen përsëri në AK për s`kualifikime apo kualifikime të padrejta të konkurrentëve. Një nga këta operatorë është “██████” i cili kërkon s`kualifikimin e të gjithë operatoreve dhe anulimin e procedurës sepse ofertat e operatorëve janë nën kostot e lejueshme ligjore. AK nuk i merr në konsideratë këto ankesa dhe operatori “██████” ankohet në KPP. Në përfundim KPP me vendimin nr. 292, datë 25.09.2015 vendos të mos pranojë ankesën e paraqitur nga ky operator ekonomik.

Në përfundim të kësaj procedura që ka zgjatur nga 30.04.2015 deri në 29.09.2015 u shpall fitues operatori “██████” me të cilin është lidhur kontrata në datën 14.10.2015, me vlerë 2,411,520.26 lekë, me afat nga data 15.10.2015 deri në datën 31.12.2015. Pra kjo procedurë u realizuar për të mbuluar më shërbimin e rojeve private periudhën nga data 15.06.2015 deri në datën 31.12.2015, me vlerë 6,368,050 lekë, në fakt u reduktua për të mbuluar vetëm periudhën nga data 15.10.2015 deri në datën 31.12.2015 me vlerë 2,411,520 lekë. Dhe për mbulimin e periudhës nga data 15.04.2015 deri në datën 15.10.2015, janë realizuar dy procedura të tjera me “Negocim pa botim paraprak”, si më poshtë:

28.4. Për mbulimin me shërbimin e rojeve private të periudhën 15.04.2015-15.06.2015 (deri sa të përfundonte tenderi kërkesë për propozim) është realizuar tenderi me “Negocim pa botim paraprak” me vlerë të përlllogaritur 1,643,115.8 lekë. TAK, i ka dërguar ftesën për negociim operatorëve ekonomikë “██████”, “██████” dhe “██████” dhe nuk i ka dërguar ftesën operatorit ekonomikë “██████”. Në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, nuk

është argumentuar dhe dokumentuar arsyeja e përzgjedhjes së 3 operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për negociim si dhe arsyeja e mos përzgjedhjes së operatorit “██████” i cili ka pasur më parë kontrata me AK. Tenderi është zhvilluar në datën 12.06.2015 dhe kanë marrë pjesë 3 operatorë. Është shpallur edhe fitues operatori “██████ & ██████” me ofertën ekonomike në vlerën 1,971,613.2 lekë, sepse një nga operatorët e tjerë ka paraqitur ofertën më të lartë për 104.8 lekë dhe tjetri nuk kanë paraqitur ofertën ekonomike.

28.5. Për mbulimin me shërbimin e rojeve private të periudhës 15.06.2015 -15.10.2015 të diktuar nga tej zgjatja e tenderit “Kërkesë për propozim” është realizuar tenderi me “Negocim pa botim paraprak” me vlerë të përllogaritur 1,643,115.8 lekë. Janë ftuar për të marrë pjesë në tenderi 3 operatorë. Edhe në këtë procedurë, TAK, i ka dërguar ftesën për negociim operatorëve ekonomikë “██████”, “██████” dhe “██████” dhe nuk i ka dërguar ftesën operatorit ekonomikë “██████”. Në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, nuk është argumentuar dhe dokumentuar arsye e përzgjedhjes së 3 operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për negociim si dhe arsyeja e mos përzgjedhjes së operatorit “██████”. Tenderi është zhvilluar në datën 11.08.2015 dhe kanë marrë pjesë 3 operatorë. Është shpallur fitues përsëri operatori “██████ & ██████” me ofertën ekonomike në vlerën 1,971,613.2 lekë, sepse të 2 operatorët e tjerë nuk kanë paraqitur ofertat ekonomike.

Për sa u trajtua më sipër duket qartë se, AK, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, duke realizuar për vitin 2015 6 procedura prokurimi me synim e vetëm favorizimin dhe dhënien e kantatës së këtij shërbimit operatorit “██████” (Trajtuar më hollësisht në faqen 92-106, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër (gjetjet 20-28.5) rekomandojmë:

-Rekomandim: Për çdo raste përdorimi i procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, duhet të dokumentohet dhe të argumentohet sipas përcaktimeve të bëra në nenin 33 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

Vazhdimisht

-Rekomandim: AK në çdo procedurë prokurimi që do të realizoi, të argumentoi hartimin kërkesave për kualifikim, përcaktimi dhe vendosja e tyre të bëhet në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që do të prokurohet.

Vazhdimisht

- Rekomandim: Në procedurat e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës që do të realizohen në zbatim të nenin 33 të ligjit të sipërcituar të mbahet dokumentacion për argumentimin e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik që do tu dërgohet ftesa për ofertë dhe për negociimin e çmimeve të ofertës me operatorin fitues.

Vazhdimisht

29. Gjetje: Nuk janë implementuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”: Nuk është caktuar koordinatori i riskut dhe nuk janë evidentuar risqet dhe masat për menaxhimin e tij. Nuk janë përcaktuar rregulla për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve të qëndrueshme në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nuk janë miratuar gjurmët për auditim, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010. Nuk janë identifikuar zonat me risk dhe rrjedhimisht nuk është përpiluar strategjia për menaxhimin e tij, nuk është hapur regjistri i riskut ku të

regjistrohen raportimet dhe masat e marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive ligjore (*Trajtuar më hollësisht në faqen 109-114., të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi: SUSHNT, të vlerësojë për sa janë konstatuar shkelje të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të marrë masat e nevojshme për implementimin e kërkesave

Menjëherë

30. Gjetje: Në kundërshtim me Statusin e SUSHN nr. 5637, datë 28.08.2006 të miratuar nga MSH dhe MASH, pasqyrat financiare nuk janë të miratuara nga Këshilli Administrativ (*Trajtuar më hollësisht në faqen 114-116., të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: Të merren masa për miratimin e pasqyrave financiare nga Këshilli Administrativ.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

1. Gjetje: AK, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, për blerjen e materialit djegës për nevojat e spitalit për ngrohje për vitin 2015, sepse ka kryer 4 (katër) procedura prokurimi fiktive, me qëllim parazgjedhjen e operatorit ekonomik “[REDAKTUAR]”. Nga këto veprime apo mosveprime ***i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën 11,924,720 lekë***, respektivisht: në procedurën e blerjes së 120,000 kg pellet të realizuar në datën 19.01.2015, për mbulimin me ngrohje të periudhës 23.11.2015-15.03.2015, është shkaktuar dëmi ekonomik në vlerën 4,252,800 lekë; në procedurën e blerjes së 123,846 kg pellet të realizuar në datën 09.03.2015, për mbulimin me ngrohje të periudhës 16.03.2011-31.10.2015, është shkaktuar dëmi ekonomik në vlerën 4,399,009 lekë; në procedurën e blerjes së 82,560 kg pellet të realizuar në datën 26.10.2015, për mbulimin me ngrohje të periudhës 01.11.2015-31.12.2015, është shkaktuar dëmi ekonomik në vlerën 158,515 lekë dhe në procedurën e marrjes me qira të 2 kaldajve të realizuar në datën 22.10.2015, për mbulimin me ngrohje të periudhës 01.11.2015-31.12.2015, është shkaktuar dëmi ekonomik në vlerën 3,114,396 lekë. Më konkretisht:

1.1. Për mbulimin e periudhës 01.1.2015-23.01.2015, AK ka lidhur një shtesë kontrate me subjektin “[REDAKTUAR]” për furnizimi me 38,328 kg pellet, me çmim 62.4 lekë/kg me TVSH, me vlerë 2,391,717 lekë. Shtesa kontratës përbën 20% të vlerës së kontratës fillestare të lidhur në vitin 2014, po me subjektin “[REDAKTUAR]” (*shtesa e kontrates nuk u auditua sepse është e lidhur në bazë të kontratës fillestare të vitin 2014*). Për mbulimin me ngrohje të spitalit për periudhën 23.01.2015 deri 15.03.2015 është realizuar procedurave të prokurimit me negociim për blerjen e 120,000 kg pellet me çmim 62.4 lekë/kg, me vlerë 7,480,000 lekë, me subjektin fitues “[REDAKTUAR]”. Për mbulimin me ngrohje të spitalit për periudhën 16.03.2015 deri 31.12.2015 është realizuar procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim” për blerjen e 123,846 kg pellet me çmim 62.4 lekë/kg, me vlerë 7,728,000 lekë, me subjektin fitues “[REDAKTUAR]”.

Në të 3 këto procedura AK ka hartuar specifikimet teknike dhe ka përllogaritur fondin limit vetëm për materialin djegës pellet i cili do të digjej në 1 Kaldajë për ngrohje dhe në 1 Kaldajë për avull. Në DT nuk janë vendosur specifikimet teknike për kaldajat, dhe nuk është përllogaritur vlera e kontratës të marrjes me qira apo blerjes së kaldajave, por në to është vendosur vetëm një kërkesë, ***që “operatori i cili do të shpallet fitues duhet të vërë në dispozicion që nga momenti i fillimit të zbatimit të kontratës deri në momentin e ndërprerjes së saj, një kaldajë 1MË dhe një kaldajë avulli 1000 kg/h”***. Mënyrën e llogaritjes së vlerave të 3 kontratave për blerjen e pelletit, AK nuk e ka të dokumentuar dhe të

argumentuar. Grupi i auditimi ju referua çmimeve zyrtare të përcaktuara në manualin e çmimeve të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) për vitin 2015. Në këtë manual, janë të përcaktuar dy çmime reference, një çmim për furnizimet nga shtetet jo anëtare të BE që shkojnë nga 115 deri në 120 Euro/m³ dhe tjetra nga furnizimet e shteteve anëtare të BE që shkon nga 150 deri në 160 Euro/m³. ***Dhe nga llogaritjet, (duke ju referuar çmimit më të lartë që është 160 Euro/m³) del se, një kg pellet është me çmimin 26.88 lekë, dhe jo 62.4 lekë që e ka përcaktuar AK. Pra çmimi është rritur më tepër për 35,52 lekë/kg. Nga kjo rritje fiktive e çmimit, fondi limit për blerjen e 282,174 kg pellet (për 3 kontratat) është llogaritur me shumë në vlerën 10,022,820 lekë.***

1.2. Tenderi me negociim për blerjen e 120,000 kg pellet me vlerë 7,480,000 lekë është zhvilluar në datën 19.01.2015. Në tender u ftuan 3 operatore ekonomik. Në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, nuk është argumentuar dhe dokumentuar mënyra dhe arsye e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të cilëve u është dërguar ftesa për negociim. Në tender nga 3 operatorë të ftuar mori pjesë vetëm 1, operatori “**[REDAKTUAR]**”. Ky operator është kualifikuar dhe më pas është shpallur fitues me çmim 62.4 lekë/kg, me vlerë oferte 7,478,640 lekë. Me këtë operator është lidhur kontrata e furnizimit të pelletit. Në nenin 2 të kontratës është përcaktuar se, në vlerën e mallit është përfshirë edhe kosto e **vendosjes së një kaldajë 1Më dhe një kaldajë avulli 1000 kg/h nga momenti i fillimit të zbatimit deri në ndërprerjen e saj**. Përfshirja e vlerës së punimeve për vendosjen e 2 kaldajave në koston e pelletit, tregon se operatori ekonomik ka marrë përsipër vendosjen e kaldajave dhe përveç vlerës së pelletit nuk do të përfitojë asnjë kosto shtesë për përdorimin dhe shfrytëzimin e kaldajave deri në përfundim të kontratës. Në lidhje me zbatimin e kësaj pike (vendosjen dhe montimin e kaldajave) në SUSHNT, nuk ka dhe nuk është mbajtur dokumentacion për punimet që janë bërë për vendosjen dhe montimin e kaldajave si: nuk ka procesverbal, preventiv të punimeve, akt-marrje në dorëzim, etj. Siç u tha më lartë për mbulimin e shërbimit të ngrohjes së spitalit për periudhën 01.01.2015-23.01.2015, është lidhur kontratë shtesë me operatorin “**[REDAKTUAR]**”, në bazë të kontratë fillestare të lidhur në vitin 2014, po me operatorin “**[REDAKTUAR]**”, çka tregon që ky operator, nuk i ka çmontuar dhe vendosur përsëri kaldajat dhe nuk ka kryer punime për vendosjen dhe montimin e tyre. ***Pra del qartë se, furnizuesi është parazgjedhur dhe procedura e prokurimit mësipërme është zhvilluar fiktivisht.*** Në vijim të zbatimit të kontratës, operatori ekonomik “**[REDAKTUAR]**” ka furnizuar SUSHNT me 120,000 kg pellet për gjatë gjithë kësaj periudhe dhe është likuiduar në vlerën e plotë të kontratës prej 7,478,640 lekë. ***Si pasojë e llogaritjes më tepër të çmimit të blerjes së pelletit për mbulimin me ngrohje të periudhës 23.01.2015 - 15.03.2015 dhe të zhvillimit formalisht të procedurës së prokurimit operatori i parazgjedhur fitues “**[REDAKTUAR]**” ka përfituar padrejtësisht në dëm të buxhetit të shtetit vlerën 4,252,800 lekë (35.52 lekë/kg x 120,000 kg).***

1.3. Tenderi “Kërkesë për propozim” për blerjen e 123,846 kg pellet me vlerë 7,728,000 lekë është zhvilluar në datë 09.03.2015. Në tender morën pjesë 2 operator ekonomik. Është kualifikuar vetëm operatori “**[REDAKTUAR]** SHPK”, i cili është shpallur edhe fitues me ofertën ekonomike, me çmim 62.4 lekë/kg me vlerën 7,727,990.4 lekë. Është s’kualifikuar operatori tjetër “**[REDAKTUAR]**” me vlerë oferte më të ulët se fituesi për 222,929. S’kualifikimi i këtij operatori është bërë në përputhje me rregullat e prokurimit publik. Ndërsa kualifikimi i operatorit “**[REDAKTUAR]**” është bërë në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik sepse, në ofertën ekonomike të tij, është konstatuar një gabim aritmetikor. Ky gabim aritmetikor është më shumë se 2 % e vlerës së ofertës dhe sipas rregullave të prokurimit publik ***ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute e të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.*** AK në vend që të anulonte

procedurën për mungesë konkurrence dhe ta rishpallte atë përsëri, e ka shpallur fitues këtë operator dhe me të ka lidhur kontratën e furnizimit. Edhe në këtë kontratë është përcaktuar se, në vlerën e mallit është përfshirë edhe kosto e **vendosjes së një kaldajë 1MË dhe një kaldajë avulli 1000 kg/h nga momenti i fillimit të zbatimit deri në ndërprerjen e saj**. Përsëri në lidhje me zbatimin e kësaj pike, nuk ka dhe nuk është mbajtur dokumentacion për punimet që janë bërë për vendosjen dhe montimin e kaldajave. Por, siç u tha më lartë furnizimin me pellet për periudhën 23.01.2015 deri 15.03.2015 e ka bërë operatori “”, çka tregon edhe njëherë që, operatori “”, nuk i ka çmontuar dhe vendosur përsëri kaldajat, pra nuk ka kryer punime për vendosjen dhe montimin e tyre. Pra, edhe në këtë procedurë furnizuesi është parazgjedhur dhe procedura është zhvilluar formalisht. Operatori “” ka furnizuar Spitalin me 123,846 kg pellet e cila nuk mbulojnë të gjithë periudhën e përcaktuar në kontratë 30.03.2015-31.12.2015, por mbulojnë vetëm periudhën 30.03.2015 deri në 31.10.2015. Për këtë sasi pelleti operatori “” është likuiduar në vlerën e plotë të kontratës prej 7,727,990.4 lekë. ***Si pasojë e llogaritjes më tepër të çmimit të blerjes së pelletit për ngrohje për periudhën 30.03.2015-31.10.2015 dhe e zhvillimit formalisht të procedurës së prokurimi subjekti i parazgjedhur fitues “” ka përfituar padrejtësisht në dëm të buxhetit të shtetit vlerën 4,399,009.92 lekë(35.52 lekë/kg x 123,846 kg).***

1.4. Për mbulimin më ngrohje të periudhës së mbetur nga 01.11.2015 deri në 32.12.2015 janë zhvilluar edhe dy procedura të tjera “Kërkesë për propozim”, 1 për blerjen e pelletit dhe tjetra për marrje me qira të kaldajave. Në procedurën e blerjes së 82,560 kg pellet, çmimi nuk është llogaritur 62.4 lekë/kg, por 25.92 lekë/kg, me TVSH me vlerë kontrate 2,139,955 lekë, dhe përsëri operator fitues i kësaj procedure është “”. Paralel me këtë procedurë për mbulimin më ngrohje të periudhës së mbetur nga 01.11.2015 deri në 32.12.2015 është hapur edhe procedura e prokurimit për “Marrje me qira dhe shërbim të 2 kaldajave”, me fond limit në vlerën 2,595,333 lekë, edhe në këtë procedurë operator fitues është përsëri “”. Llogaritja fondi limit të pelletit është bazuar në çmimet mesatare të tregut, dhe ka dalë 25.92 lekë/kg, me TVSH. Vlera e fondit limit për blerjen e 82,560 kg pellet është llogaritur 2,139,955 lekë. Po të krahasojmë llogaritjen e fondit limit dhe hartimin e specifikimeve teknike me dy procedurat e para duket qartë se, fondi limit i përcaktuar nga studimi i tregut tregon se çmimi i 1 kg pellet është pothuajse i barabartë me çmimin referencë të pelletit të përcaktuar në manualin e çmimeve të DPD, për vitin 2015. Po kështu edhe specifikimet teknike të pelletit (karakteristikat) janë të njëjtat me specifikimet teknike të hartuara në dy procedurat e para. ***Ky krahasim përforcon dhe të jep siguri që dëmi ekonomik i konstatuar nga auditimi në të dy procedurat e mësipërme (me negocim dhe kërkesë për propozim) është i saktë dhe objektiv.*** Në specifikimet teknike të procedurës për blerjen e 82,560 kg pellet, ***AK nuk ka vendosur kërkesën që “operatori që shpallet fitues duhet të vërë në dispozicion një kaldajë 1MË dhe një kaldajë avulli 1000 kg/h që nga momenti i fillimit të zbatimit të kontratës deri në momentin e ndërprerjes së saj”,*** e cila ishte kërkuar në të dy procedurat e para sepse, paralel me këtë procedurë siç u tha më sipër, është hapur edhe procedura e prokurimit për “Marrje me qira të kaldajave”. Llogaritja e fondi limit të qirasë së kaldajave është bazuar në çmimet mesatare të tregut. Dhe çmimi i marrjes me qira të dy kaldajave për periudhën 01.11.2015 deri në 32.12.2015 është llogaritur në vlerën 3,114,399.6 lekë, me TVSH. Po kështu AK, ka hartuar specifikime teknike të kaldajave (karakteristikat e kaldajave) më të cilat ka kërkuar që operatori ekonomik fitues duhet të kryej këto punime: hapjen e murit dhe kthimi përsëri në gjendje të mëparshme, vendosja e aparaturave të domosdoshme të matjes së nxehtësisë të avullit, vendosja e saraçineskave të shpërndarjes së avullit dhe të ujit dhe tubat lidhëse dhe përgatitja e furrave me tulla dhe llaç shamot. Duket qartë se, llogaritja e fondit limit për marrjen me qira të dy kaldajave është bërë apriori. Nuk është bërë studim tregu në lidhje me vlerat e qirasë e cila duhet të dalin sipas

llojit, madhësinë e kaldajave, harxhimin e pelletit, konsumin energjinë elektrike, etj. Por vlera e qirasë është përcaktuar nga mesatarja e vlerës së 3 ofertave që janë marrë fiktivisht në treg, të cilat nuk japin të dhëna të hollësishme në lidhje me tarifën e qirasë, çmimin e kaldajave, llojin e kaldajave dhe të dhëna të tjera teknike të tyre. Fiktiviteti në llogaritjen e fondit limit, ka ardhur si pasojë e hartimit të specifikimeve teknike të kaldajave të cilat nuk shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, në lidhje me karakteristikat teknike të tyre si, rrëgjimin e punës, parametrat teknik, kapacitetin, materialin djegës, programimin automatik apo manual, etj. Por, thuhet, “Karakteristikat e kaldajave” dhe për to jepen të dhëna vetëm për vendosjen e kaldajave dhe jo të dhëna për karakteristikat teknike të tyre. Mungesa e këtyre të dhënave e bën të pa mundur llogaritjen e vlerës së qirasë (përdorimit) të kaldajave, sepse vlerat e qirasë do të llogariten në bazë të këtyre të dhënave. Ndodhur në këto kushte, llogaritja e vlerës së qirasë është bërë në mënyrë të thjeshtë mekanike, duke zbritur çmimin e pelletit prej 25.92 lekë/kg dhe vlera që mbetet është llogaritur si fond limit për qiranë e kaldajave. Dhe po të bashkojmë po mekanikisht vlerën e qirasë së kaldajave me vlerën e pelletit do të dali çmimi i pelletit rreth 62-63 lekë, sa çka qenë edhe çmimi i pelletit në procedurat e mëparshme. Këto shkelje janë konstatuar edhe nga Zv/Dretori i spitalit që mbulon anën ekonomike dhe nga një operator ekonomik i interesuar për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, të cilët janë ankuar, por ankesat e tyre nuk janë marrë konsideratë nga AK.

1.5. Tenderi për “Blerje lëndë djegëse për ngrohje, Pellet”, është zhvilluar në datën 26.10.2015 dhe kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik. Nga 3 operatorë ekonomikë, është kualifikuar vetëm operatori “████████”, i cili është shpallur edhe fitues me ofertën ekonomike në vlerën 1,783,296 lekë pa TVSH. Janë s’kualifikuar dy operatorët e tjerë, “████████” dhe “████████”. S’kualifikimin i operatorit “████████” është bërë në përputhje me rregullat e prokurimit publik sepse nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. Ndërsa për vlerësimin e ofertave teknike të 2 operatorëve të tjerë KVO ka përdorur dy standarde sepse, nga njëra anë ka s’kualifikuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik operatorin “████████” i cili ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në DT dhe ka paraqitur ofertën ekonomike me vlerën më të ulët, dhe nga ana tjetër ka kualifikuar operatorin “████████” në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik pasi nuk ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në DT. Nga ky veprim i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik **në vlerën 158,515 lekë**, e cila llogaritet si ████████ e ofertës së operatorit “████████” të shpallur fitues padrejtësisht me ofertën e operatorit “████████” të s’kualifikuar padrejtësisht.

1.6. Tenderi për “Marrje me qira dhe shërbim për kaldajë 1Më dhe kaldajë avulli 100 kg/h”, është zhvilluar në datën 22.10.2015 dhe kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomik. Nga 2 operatorë është kualifikuar vetëm operatori “████████” dhe është shpallur fitues me ofertën në vlerën 2,595,330 lekë, dhe është s’kualifikuar operatori tjetër “████████” i cili ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët me difference të papërfillshme. Edhe për vlerësimin e këtyre ofertave janë përdorur dy standarde sepse, nga njëra anë është s’kualifikuar operatori “████████” për arsye se, nuk disponon Certifikatë ISO 9001-200 dhe Certifikatën e Pajisjeve Nën Presion për Kaldajat, por nga auditimi u konstatua se, ky operator i ka paraqitur këto dokumente dhe duhej të kualifikohej, dhe nga ana tjetër ka kualifikuar operatorin “████████” edhe pse nuk ka paraqitur Certifikatën e Pajisjeve Nën Presion për Kaldajat. Mungesën e këtij dokumenti e ka konstatuar edhe një anëtar i KVO i cili ka s’kualifikuar operatorin “████████”, por ky është kualifikuar me votat e 2 anëtarëve të tjerë. Me operatorin fitues është lidhur kontrata e qirasë me vlerë 3,114,396 lekë. Në nenin 2 të kontratës është përcaktuar se, në vlerën e mallit është përfshirë edhe kosto e **vendosjes së një kaldajë 1Më dhe një kaldajë avulli 1000 kg/h (sipas specifikimeve të dokumenteve të tenderit) nga momenti i fillimit të**

zbatimit deri në ndërprerjen e saj. Dhe në nenin 3 është përcaktuar se, furnizuesi i shërbimeve duhet të bëjë, hapjen e murit dhe kthimi përsëri në gjendje të mëparshme, vendosjen e aparaturave të domosdoshme të matjes së nxehtësisë të avullit, vendosjen e saraçineskave të shpërndarjes së avullit dhe të ujit dhe tubat lidhëse dhe përgatitjen e furrave me tulla dhe llac shamot. Nga auditimi në lidhje me këtë pikë u konstatua se, nuk është mbajtur dokumentacion për të justifikuar punimet që janë bërë për vendosjen dhe montimin e kaldajave, si: nuk ka procesverbal, nuk ka preventiv të punimeve, nuk ka situacion, nuk ka aktmarrje në dorëzim të punimeve, fatura tatimore, etj.

Siç u trajtuar më lartë për mbulimin e shërbimit të ngrohjes së spitalit për periudhën 01.01.2015-31.10.2015 janë lidhur tre kontrata me operatorin “██████” për furnizimin me pellet. Pra kuptohet qartë se, kaldajat kanë qenë të vendosura para vitit 2015 nga operatori “██████”, dhe për to ky operator nuk ka përfituar vlerën e qirasë, sepse në DT ka qenë kusht që operatori fitues duhet të dispononte kaldajat dhe ti vinte në dispozicion të AK. Kjo është arsyeja që AK në procedurat e prokurimit të realizuara në vitin 2015 dhe në veçanti në dy procedurat e fundit ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik duke s`kualifikuar padrejtësisht operatorë të tjerë dhe duke kualifikuar dhe shpallur fitues po padrejtësisht operatorin “██████”. Dhe, meqenëse kosto e blerjes së pelletit për periudhën janar-tetor 2015 ka qenë më e lartë se kosto e tregut të kësaj periudhe e vërtetuar kjo nga çmimi në manualin e DPD dhe nga çmimi i tregut të nxjerrë po nga vetë AK për llogaritjen e fondit limit të blerjes së pelletit në muajin Nëntor 2015, u sajua një procedurë prokurimi fiktive për marrjen me qira të kaldajave në vlerën **3,114,396 lekë** me qëllimin përfitimin e kësaj vlere nga operatori ekonomik i parazgjedhur “██████”.

(Trajtuar më hollësisht në faqen 63-77, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim: Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për ti kërkuar operatorit ekonomik “██████”, shpërblimin e dëmit **në vlerën 11,924,720 lekë.**

2. Gjetje: Me përfundimin e procedurave të prokurimit të përqendruar të realizuara nga Ministria e Shëndetësisë, në datën 29.08.2014, SUSHNT, ka lidhur një kontratë shërbimi me subjektin “██████” për “Mirëmbajtjen e 3 pajisjeve mjekësore të prodhuara nga kompania Siemens, 1 “Angiograf”, 1 “Shintigraf” dhe 1 “CT Skaner” me vlerë të përgjithshme **92,184,000 lekë.** Afati i mirëmbajtjes së “Angiografit” dhe “Shintigrafit” është përcaktuar 24 muaj duke filluar nga data 01.09.2014 deri në 31 gusht 2016, respektivisht, “Angiografi” me vlerë shërbimi 26,160,000 lekë dhe “Shintigrafi” me vlerë shërbimi 8,600,000 lekë, ndërsa afati i mirëmbajtjes së “CT Skanerit” është përcaktuar po 24 muaj, por duke filluar nga data 01.01.2015 deri në datën 31.12.2016 me vlerë shërbimi 42,060,000 lekë. Sipas nenit 2 dhe 3 të kontratës, në vlerën e përgjithshme përfshihen të gjitha shërbimet përkatëse të mirëmbajtje së pajisjeve, të nevojshme për funksionimin normal të tyre, ose e thënë ndryshe kjo kontratë mirëmbajtje është e tipit “FULL RISK”. Për shërbimet e kryera për mirëmbajtjen e këtyre pajisjeve mjekësore gjatë periudhës shtator 2014 deri në shkurt 2016; spitali i ka paguar subjektin “██████” shumën e plotë sipas kontratës në vlerën totale **60,250,236 lekë.** Nga auditimi mbi kryerjen e shërbimit të mirëmbajtjes dhe nga verifikimi në vend mbi përdorimin dhe funksionimin e këtyre pajisjeve, u konstata se:

-Pajisja mjekësore “Angiografi” (koronografi), nuk ka qenë në përdorim dhe në funksion që nga data 01.09.2014 deri në 31.08.2015. Ndërsa për periudhën 01.09.2015 deri në momentin e auditimit, ka qenë në përdorim dhe në funksion të plotë të cilës i është bërë mirëmbajtje e plotë në përputhje me kontratën. Mirëpo spitali, ka kryer pagesa në favor të subjektit privat “██████” për shërbimin e mirëmbajtjes për të gjithë periudhën e kontratës

shtator 2014 deri në shkurt 2016 me vlerën e plotë prej 23,522,736 lekë, në vend që të kryente pagesa vetëm për periudhën e funksionimit dhe përdorimit të pajisjes që është shtator 2015 deri në shkurt 2016 në vlerën 7,912,588 lekë. Kështu, subjekti privat “**██████**” ka përfituar padrejtësisht, ***në dëm të buxhetit të shtetit vlerën 15,610,148 lekë për shërbimin e pa kryer nga data 01.09.2014 deri në 31.08.2015.*** Mos vënia në punë e kësaj pajisjeje dhe mos qenia e saj nën mirëmbajtje të plotë gjatë periudhës 01.09.2014 deri në 31.08.2015 vërtetohet: Nga, mungesa e të ardhurave që do të përfitoheshin nga tarifat e përdorimit të kësaj pajisjeje, të cilat gjatë kësaj periudhe kanë qenë 0 (zero). Ndërsa nga periudha 01.09.2015 deri në 20.02.2016, janë përfituar të ardhura nga tarifat e përdorimit në vlerën 1,160,000 lekë. Nga, fletë-dalja e magazinës së spitalit me nr. 112, datë 25.08.2015, që vërteton se, kjo pajisje mjekësore nën përgjegjësinë e magazinierit të spitalit, me këtë fletë-dalje në datën 25.08.2015, kalon nën përgjegjësinë e mjekëve që do të përdorin këtë pajisje. Dhe nga, vërtetimi i lëshuar në datën 24.02.2016, nga vetë mjekët që kanë përdorur këtë pajisje të cilët në respekt të kërkesës sonë kanë vetë-deklaruar se, vënia në përdorim dhe funksion të kësaj pajisjeje ka filluar në datën 01.09.2015.

-Pajisja mjekësore “Shintigrafi”, e cila shërben për diagnostikimin e disa sëmundjeve të mushkërive, nuk ka qenë në përdorim dhe në funksion që nga data 01.09.2014 dhe akoma deri në momentin e auditimit, ***nuk është në përdorim.*** Mos vënia në përdorim dhe në funksion të kësaj pajisjeje mjekësore, është justifikuar nga spitali për mungesë të mjekut specialist për përdorimin e saj. Mirëpo edhe për mirëmbajtjen e kësaj pajisjeje, e cila nuk ka qenë asnjëherë në punë, spitali ka paguar në favor të subjektit “**██████**” ***dhe në dëm të buxhetit të shtetit vlerën e plotë prej 7,733,041 lekë të shërbimit të mirëmbajtjes për të gjithë këtë periudhën që nga data 01.09.2014 deri në shkurt të vitit 2016.***

Konkluzion: Drejtori i SUSHN me cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor ka vepruar në kundërshtim të hapur me kontratën e sipërcituar dhe në mënyrë specifike me nenin 8 të saj, në të cilin qartësisht përcaktohet se: *“Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën gjatë periudhës së ekzekutimit të kontratës, të përfshijë apo të përjashtojë nga shërbimet e përmendura, pajisje të caktuara, veprim ndaj të cilit, Kontraktuesi nuk ka të drejtë të kundërshtojë. Ky ndryshim do të rezultojë në rishikim të kontratës. Vlera e shtuar ose e zvogëluar do të llogaritet bazuar në vlerën ditore të mirëmbajtjes për atë pajisje dhe ditëve të përfshirjes në mirëmbajtje”*. Si pasojë e veprimeve apo mosveprimeve të këtij zyrtari, i është shkaktuar buxhetit të shtetit dëm ekonomik në vlerën e përgjithshme 23,343,189 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 106-109, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim: Nga Titullari i Autoritetit Kontraktor Të merren masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit **në vlerën 23,343,189 lekë.**

B.1. MASA PËR PËRDORIMIN ME EFEKTIVITETE TË FONDEVE

1. Gjetje. Në tenderin “Kërkesë për propozim” të zhvilluar në vitin 2105 për “Blerje materiale mjekimi për nevojat spitalore” me fondit limit 4,349,946 lekë, me fitues subjektin “**██████**” me vlerë kontrate 5,124,060 lekë, është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, për pasojë janë përdorur fonde në vlerën 624,060 lekë, pa efektivitet, ekonomikitet dhe eficensë. Sepse, KVO gjatë vlerësimit të ofertave teknike ka s`kualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “**██████**” i cili i plotësonte të gjitha kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në DT. Ky operatore i s`kualifikuar ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët se operatori i kualifikuar dhe shpallur fitues “**██████**” me diferencë më pak në vlerën 624,060 lekë *(Trajtuar më hollësisht në faqen 77-81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim: SUSHNT, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, për të nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mospërdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efecensë të fondeve publike **në vlerën 624,060 lekë .**

2. Gjetje. Në tenderin “Me negociim pa botim paraprak të kontratës” të zhvilluar në janar të vitin 2105 për “Blerje medikamente për nevoja spitalore” me fondit limit 19,101,350 lekë, me fitues subjektin “██████” me vlerë kontrate 19,050,000 lekë, është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, për pasojë janë përdorur fonde në vlerën 5,250,791 lekë, pa efektivitet, ekonomikitet dhe efecensë. Sepse, AK, për 61 medikamente ka përcaktuar çmime më të larta se, çmimet e përcaktuara në listën e Ministrisë së Shëndetësisë, në vlerë të përgjithshme 5,250,791 lekë. Po kështu edhe operatori fitues i tenderit me të cilin është lidhur kontrata e furnizimit nëpërmjet procedurës me negociim, të 61 këto medikamente i ka paraqitur në ofertën e tij me çmimet më të larta se, çmimet e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë për medikamentet që do të blihen gjatë vitit 2015 në të gjithë sistemin e Shëndetësisë, nëpërmjet procedurave të prokurimit, duke bërë kështu që 5,250,791 lekë fonde buxhetore të përdoren, pa efektivitet, ekonomikitet dhe efecensë (*Trajtuar më hollësisht në faqen 90-91, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: SUSHNT, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, për të nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mospërdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efecensë të fondeve publike **në vlerën 5,250,791 lekë.**

3. Gjetje. Në tenderin “Kërkesë për propozim” të zhvilluar në vitin 2105 për “Evadimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore” me fondit limit 2,394,648 lekë, me fitues subjektin “██████” me vlerë kontrate 2,873,549 lekë, është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, për pasojë janë përdorur fonde në vlerën 1,002,749 lekë, pa efektivitet, ekonomikitet dhe efecensë. Sepse, KVO gjatë vlerësimit të ofertave teknike ka s`kualifikuar padrejtësisht operatorin ekonomik “██████” i cili i plotësonte të gjitha kërkesat e ligjore dhe të kërkesat e veçanta të vendosura në DT. Ky operatore i s`kualifikuar ka paraqitur ofertën ekonomike më të ulët se operatori i kualifikuar dhe shpallur fitues “██████” me diferencë më pak në vlerën 1,002,749 lekë(*Trajtuar më hollësisht në faqen 81-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: SUSHNT, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, për të nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mospërdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efecensë të fondeve publike **në vlerën 1,002,749 lekë.**

4. Gjetje: Në tenderin për “Blerje materiale mjekësore për hemodinamikën”, të realizuar në datën 05.05.2015, me fond limit në vlerën 5,273,704 lekë me fitues operatorin “██████”, me vlerë kontrate 5,784,516 lekë, është vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, sepse disa kriteret e veçanta kualifikuese të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit nuk janë hartuar dhe përcaktuar në përpjesëtim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që do të prokurohet. Vendosja e këtyre kërkesave është bërë shkak që është s`kualifikuar operatori ekonomik “██████” me ofertë ekonomike më të ulët se, operatori tjetër i kualifikuar dhe i shpallur fitues “██████”, duke bërë që 3,094,716 lekë, fonde buxhetore të përdoren pa efektivitet. Kjo vlerë llogaritet nga diferenca e vlerës së ofertës ekonomike të operatorit fitues “██████” që është në vlerën 5,784,516 lekë me diferencën ofertës ekonomike të operatorit të s`kualifikuar “██████” që është në vlerën 2,689,800 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqen 86-90, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim: SUSHNT, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, për të nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mospërdorim me efektivitet, ekonomikitet dhe efecensë të fondeve publike **në vlerën 3,094,716 lekë.**

C. KALLZIM PENAL

Bazuar në kualifikimet e neneve 248 “Shpërdorimi i detyrës” dhe 258 “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të Kodit Penal, bëjmë kallëzim penal për: **z.P.K, Drejtor i Spitalit Universitar Shefqet Ndroqi, Tiranë**, me cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, pasi ka kryer veprime të kundërligjshme të cilat referuar përmbajtjes së dispozitës penale, neni 248 dhe neni 258 i Kodit Penal, mbartin elementët e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tenderë apo ankande publike”.

Shenim: Bazuar në nenin 22 të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999, “Për informacionin e klasifikuar” i ndryshuar, Kallëzimi Penal nuk publikohet.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të rekomandimeve të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja e Shoqërive Publike si dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikes.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R